

TY 5\* UAI  
(tarif 11.99)7 netë  
27.06.12

636€

CE 5\* HAI  
(tarif 11.99)7 netë  
27.06.12

812€

URQI  
n'shpi

7 netë

KEMER 3\* AI  
11.99ANYA 4\* AI  
11.99IER 4\* AI  
11.99LANYA 5\* AI  
11.997 netë  
27.06.12IBR 5\* UAI  
634€MER 4\* AI  
486€FSIDES\* UAI  
606€\* UAI  
588€ANYA 5\* UAI  
635€BR 5\* UAI  
783€ASIDES\* UAI  
623€15\* UAI  
679€\* AI  
654€PEK 5\* UAI  
658€

ansfert APG-HTL-APL

RATIS

511 991

www.airtour.net



Një kontingjent prej 53 pjesëtarësh të Forcës së Sigurisë të Kosovës do të zbarkojë në Vlorë më 28 nëntor, për ta madhështuar kremten e 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë. Ata do të janë të veshur me uniformën e re të FSK-së.

FORCA E SIGURISË E KOSOVËS SYNON TË BËHET USHTRI E STANDARDIZUAR ME PAJISJE BASHKËKOHORE

## "Ushtarët" i presin armët dhe uniformat e reja

Komandanti i FSK-së, Kadri Kastrati, nuk e ka mohuar se "ushtarët" e tij janë të paarmatosur, ndonëse shumë armë të kalibrit jo të rëndë gjenden në depo. "Ende nuk kemi armë pér secilin pjesëtar, dhe po t'i shpërndajmë në këtë kohë, armët do të lëviznin nga një dorë në tjetrën dhe ashtu vetëm do të dëmtohen", ka shpjeguar ai, duke u shprehur optimist se kjo gjendje do të përfundojë sivjet. Po këtë vit FSK-ja, sipas tij, do ta ndërrojë edhe uniformën

Agron Halitaj

PRISHTINE, 19 QERSHOR - Një kontingjent prej 53 pjesëtarësh të Forcës së Sigurisë të Kosovës do të zbarkojë në Vlorë më 28 nëntor, për ta madhështuar kremten e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë. Askush nuk e di se si do të duken pjesëtarët e kësaj forcë, por një gjë tashmë është vendosur. Ata do të jenë të veshur me uniformën e re të FSK-së. Komandanti i kësaj forcë, Kadri Kastrati, i ka njoftuar të martën anëtarët e Komisionit përmbytëgjyje të FSK-së se brenda javësh një komision i veçantë i FSK-së do të fillojë negocimet me kompanitë pretendente pér t'i qepur uniformat e reja. Dalja e parë publike me uniformë të reja parashihet të bëhet pikërisht në Diten e FSK-së.

"Më 27 nëntor të ketë viti, kur është edhe Dita e FSK-së, pjesëtarët e Forcës së Sigurisë do të rreshtohen me uniformën e re", ka thënë Kastrati.

Por, krahasuar me nevojat e tjera që i ka kjo forcë siguri, veshjet nuk shihen si preokupim kryesor pér udhëheqësit e FSK-së.

Transformimi në ushtri dhe pajisja me armë paraqitet si synimi kryesorë të tyre.

Komandanti i FSK-së nuk e ka mohuar që "ushtarët" e tij ende nuk janë pësuar me armë, edhe pse shumë sosh, ndonëse të kalibrit jo të rëndë, gjinden në depo.

Gjeneral Kastrati ka dhënë edhe shpjegimin pér këtë gjendje.

"Ende nuk kemi armë pér secilin pjesëtar, dhe po t'i shpërndajmë në këtë kohë, armët do të lëviznin nga një dorë në tjetrën dhe ashtu vetëm do të dëmtohen", ka shpjeguar ai. Kastrati është shprehur optimist se kjo gjendje nuk mund të zgjasë edhe shumë. "Po e presim kontingjentin e ardhshëm të armëve që të na vijë që atëherë secili do ta ketë armët e vet. Unë do ta përgatis urdhri pér shpërndarjen e armëve nëpër kazerma, dhe atëherë secili individ do të bëhet përgjigjës pér armën e tij. Besoj se kjo do të ndodhë sivjet", ka deklaruar Kastrati. Ai ka njoftuar se aktualisht janë duke u bërë plane që të porositen snajperë dhe mitralloza 7.62 milimetra.

Tash për tash për personelin e FSK-së, i cili numeron gjithsej 2386 ushtarakë, 2194 meskuj e 192 femra, janë të dedikuara dy illoje të armëve të gjata dhe një lloji i armëve

të brezit: pushkë HK, 1275 copë; pushkë Colt, 550 copë dhe revole Glock 486 copë. Pavarësisht nevojave të FSK-së pér armatën dhe pajisje të tjera ushtarake, gjeneral Kastrati ka zgjedhur që të mos pranojë çfarëdo që i faljet nga të tjera.

"Shumë shtere të NATO-së janë duke e lënë Kosovën dhe janë duke na ofruar mijte dhe pajisje të ndryshme ushtarake, por nuk kemi miratuar një standard, dhe duhet t'u themi falenderimet, por këto nuk janë të standardizuar. Kjo përfaktikisht ka qenë shumëlojshëmëri të automjeteve dne të pajisjeve krijohet një konfuzion brenda FSK-sës dñe kjo do të na kushtonte shumë", ka thënë Kastrati.

Ai e ka pranuar se automjetet ekzistuese në FSK janë të ardhura nga furnizues të ndryshëm, në perundha të ndryshme.

"Një pjesë e tyre vijnë nga perundha e TMK-së, disa të tjera kanë ardhur nga donacione e ndryshme dñe pjesë është blerë nga buxheti i Qeverisë së Kosovës....", ka shqaruar Kastrati. Gjendja e pajisjeve ekzistuese, siç ka thënë ai, nuk mund të konsiderohet e mirë, përfaktin se një pjesë e madhe e tyre janë të vjetra dhe të amortizuara dhe kërkohjnë mijte të shumta përmirësojje dhe riparim.

### Trajnim i detyrueshëm

Kastrati ka thënë se synim kryesor përvit 2012 e ka zhvillimin dhe ngritjen e një forca profesionale, ndërvepruese, të vetëqëndrueshme dñe pësuar me sisteme të teknikës dne të pajisjeve bashkëkohore. "Synim imi është që FSK-ja të bëhet një forcë e afër përvizuar edhe në mëdijëse më kompleks dne përvizuar që së paku rishikimit të missionit të FSK-së", është shprehur Kastrati.

Ai ka njoftuar mbikëqyrësitë parlamenterat pér trajnimet e shumta që pjesëtarët e FSK-së i kanë bërë dhe janë duke i bërë qoftë jashtë, qoftë brenda vendit. Por edhe në këtë aspekt, Kastrati ka bërë një ndërhyrje. Ka vendosur që trajnimin të mos e lërrë në vuillnesh e pjesëtarëve të FSK-së, por ta shndërrojet në urdhër përzbatim. Ai ka thënë se ekziston edhe arsyja që e ka shtyrë përvizuar që marë një vendim të tillë.

"Na ka ndodhur që do ditë para se me u nis pér trajnim, pjesëtarë të

FSK-së kanë thënë se nuk mund të shkijnë pér shkaqë familjare. Tash, ai që refuzon trajnimin automatikisht përashtohet nga FSK-së", ka bërë të ditur Kastrati.

Ai ka paralajmëruar se konform Ligjit pér pensionim të pjesëtarëve të FSK-së, që është nuk, do të pensionohen 53 pjesëtarë që i kanë plotësuar kriterit pér pensionim. Ndërkohë, Kastrati ka njoftuar se një trajnim disajavor do të mbahet sivjet edhe me pjesëtarët rezervë të FSK-së.

Operacionin më të madh që FSK-ja e ka kryer deri tanë, ai e ka cilësuar atë në fshatin Restelicë, me rastin e nxjerës së dhitjetë viktivave nga rrënojat e shtëpive që u shkatërruan nga orteku i borës.

Kastrati ka rekomanduar që FSK-ja të jetë prioritet i Qeverisë në planet afatmatore dne afatgjata të saj. Sipas tij, Qeveria duhet të planifikojë buxhet shtesë apo të shikojë mundësitet për kredi afatgjate, përfaktin se pajisjet moderne që pretendon t'i ketë FSK-ja në të ardhmen kanë kostë të lartë, dhe mund të përballohen me buxhetin e tanishëm të kësaj forcë.

Buxheti i aprovarë për FSK-në përvit 2012 është 35.801.832 euro, përdorësia në pesëmuajorit: e parë kjo forcë i ka shpenzuar 8.917.96 euro, apo 25 % të mjeteve.

Komandanti i FSK-së, Kadri Kastrati, ka thënë se FSK-ja nuk do të transformohet më, por vëtëm do të evoluhet në ushtri të ardhshme të Kosovës.

### FSK ja pas përfundimit të "mbikëqyrjes së pavarësisë"

Të enjten, në Kuvendin e Kosovës do të shqyrtohet në parim Projekti i përfundimit të mbikëqyrjes së pavarësisë, në kuadër të të cilit janë edhe disa amendamente që kanë të bëjnë me FSK-në.

Especiale është se në Ligjin pér FSK-në është propozuar që fshihet dërehe të riformulohet paragrafi 2 i ninjtë 10, i cili flet pér armatimin e FSK-së dne rolin që e ka përfaqësuesi kivil ndërkombe të këtë proces. Në ligjin e ri është hequr pjesa ku thuhet se: "Cdo ndryshim në armatim do të përcaktohet nga prania ushtarake ndërkombe, dñe bashkerendim me Përfaqësuesin Ndërkombe Civil", por në të nuk është specifikuar nëse ndryshimi në armatim në

ardhmen do të përcaktohet nga Qeveria. I pandryshuar ka mbetur afiti kur FSK-ja do të mund të kerkonte rishikim të kufizimeve në armatim.

Një kërkesë e tillë është paraparë të merret parasysh tek pas pesë vjetësh nga dita e hyrjes nuk që fuqi të ligjit pér FSK-në.

Ky ligj është miratuar në mars të vitit 2008, kështu që rishikimi i armatimit i bie se mund të bëhet në pranverën e vitit të ardhshëm.

"Forca e Sigurisë e Kosovës është e armatosur lehtë dhe nuk do të ketë armë të rënda, siç janë tanket, artilleria e rëndë apo kapacitete sulmuese ajrose. Një rishikim i plotë i këtyre kufizimeve do të bëhet jo më herët se pesë vjet nga koha e hyrjes nuk që fuqi e Ligjin nr.03/L-046 pér Forcen e Sigurisë të Kosovës. Detarit fillostarë të Forcës së Sigurisë të Kosovës janë: [...] ", thuhet në amendamentin e propozuar pér ndryshim.

Ministri i Forcës së Sigurisë, Agim Çeku, ka bërë të ditur se Qeveria e Kosovës nuk do ta presë qershori e vitit të ardhshëm pér ta rishikuar misionin e Forcës së Sigurisë.

"Me vendimin e 21 marsit të këtij viti, Qeveria ka vendosur të rishikohet jo vetëm FSK-ja, por i tërë sektorë i sigurisë në Kosovë", ka thënë Çeku.

Komandanti i FSK-së, Kadri Kastrati, ka thënë se FSK-ja nuk do të transformohet më, por vëtëm do të evoluhet në ushtri të ardhshme të Kosovës.

Ministri i Forcës së Sigurisë, Agim Çeku, ka bërë të ditur se Qeveria e Kosovës nuk do ta presë qershori e vitit të ardhshëm pér ta rishikuar misionin e Forcës së Sigurisë.

"Me vendimin e 21 marsit të këtij viti, Qeveria ka vendosur të rishikohet jo vetëm FSK-ja, por i tërë sektorë i sigurisë në Kosovë", ka thënë Çeku.

Ai ka thënë se qëllimi kryesor përvizuar që të nxirret një strategji e sigurisë kombëtare, e cila do ta derinonte qartë të ardhshëm e sigurisë vendëse.

Strategjia e sigurisë, sipas tij, do të garantonë pesë gjëra. "Ushtrimin e sovranitetit në tërë territorin e Kosovës; mbrojtjen e pavaresejës dhe integritetit territorial të Kosovës; mbrojtjen e jetes dne pronës së të gjithë qytetarëve të Kosovës; anëtarësimin e Republikës së Kosovës në të gjitha strukturat ndërkombe të sigurisë, dñe e pesta, shndërimi i Kosovës nga konsumuesi i sigurisë në kontribuues të sigurisë", ka shqaruar Çeku.

Këtë proces, siç ka thënë ai, do ta udhëheqë një komitet drejtues nga ministri që kanë të bëjnë me cështjet e sigurisë, drejtori të agjencji të sigurisë, anëtarë të Kuvendit dhe të Presidencës. Kryesues i Komitetit do të jetë vetë Çeku, ish-komandant i Trupave Morojtëse të Kosovës.